

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku- kryetar i kolegjit, Ferit O.i dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarve O.M. dhe E.M., që të dy nga fshati ..., Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit, nga neni 358 par. 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit O.M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë, P.nr.154/2018, datë 03.01.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit O.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Dega në Podujevë, P.nr.154/2018, datë 03.01.2019, **vërtetohet**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, me aktgjykimin P.nr.154/2018, datë 03.01.2019, të akuzuarit O.M. dhe E.M. i ka shpallur fajtorë për veprën penale Vjedhja e pyllit, nga neni 358 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe secilin veç e veç e ka gjykuar me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda afatit prej 1 (një) viti nuk kryejnë vepër të re penale, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, si dhe dënim me gjobë në vlerë prej 200 €, të cilin dënim të akuzuarit secili veç e veç janë detyruar ta paguajnë në afat prej 3 muajsh, në dy këste mujore, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë. Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë brenda afatit të caktuar më lartë, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € të gjobës, do t'iu llogaritet një ditë burgim. Janë detyruar të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit të paguajnë shumën prej 20 €, secili veç e veç, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari O.M., dhe atë vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë dhe i njëjti të lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.136/2019, datë 12.02.2019, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit O.M. është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarve.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

I akuzuari O.M. e ankimon aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket vendimit mbi dënimin duke pretenduar se i akuzuari O.M. dhe familja e tij i përkasin gjendjes së rëndë dhe të vështirë ekonomike sociale, se është i papunë dhe mbajtës i vetëm i familjes me prindërit e sëmurë, se i njëjti ka humbur vëllain e tij në aksident komunikacioni, e i akuzuari përkujdeset për dy fëmijët e të njëjti vëlla e ndërsa për nënën e fëmijëve respektivisht për bashkëshorten e vëllait të ndjeri përkujdeset i akuzuari ngase e njëjta nga aksidenti ka pësuar lëndime të rënda trupore. Në këtë rast, sipas të akuzuarit duke u bazuar në gjendjen faktike dhe rrethanat lehtësuese, konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë sa i përket lartësisë së dënimit i cili është në kundërshtim edhe me praktikën gjyqësore dhe nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore për matjen dhe zbutjen e dënimit, sikurse që parashihet me dispozitat ligjore, ngase dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë për të akuzuarin është në shpërpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me një rast mbijetese për cka i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje dhe pendesë të sinqertë për rastin e ndodhur dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë veprime të tilla. Andaj, i njëjti po ashtu konsideron se dënimi i shqiptuar nuk është në përputhje me qëllimin e tij, ngase i njëjti dënim mund të ndikoj negativisht edhe në përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike të akuzuarit dhe familjes së tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të akuzuarit O.M., për shqyrtimin e një dënim më të butë, nuk janë të bazuar. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të njëjtin të akuzuar, konform nenit 73 të

KPRK-së, ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku për të akuzuarin, në rastin konkret si rrethanë lehtësuese gjykata e shkallës së parë mori parasysh: se i njëjti në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, gjendjen e vështirë ekonomike-sociale, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata e shkallës së parë për të akuzuarin ka pasur parasysh faktin se i njëjti ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepra të njëjta penale. Një vlerësim të këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kolegji i kësaj gjykate dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimet e të akuzuarit për një dënim më të butë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e të akuzuarit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re lehtësuese e që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e që do të ndikonte në një dënim më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbejë preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikojë në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë konform të dispozitave të nenit 401 të KPPK-s u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.115/19, datë 25.02.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit O.i
Biljana Rexhiq